



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESORE PRIVAT  
ZYRE PERMBARIMORE L.D.C.

Nr. 514/31 Prot.

Tirane, me 04.09.2019

**URDHER**  
**“PER VENDOSJEN E SEKUESTROS”**

Drejtuar: **Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane**

Me vendimin gjyqesor Nr.819, date 07.02.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, te lene ne fuqi me vendimin nr. 1696, date 05.07.2017 te Gjykates se Apelit Tirane, eshte vendosur:

-Detyrimi i Astrit Vata, i biri i Nezirit, i dtl.06.11.1956 dhe Ardit Vata, i biri i Astritit, i dtl. 07.02.1989, te paguajne ne favor te Hamid Gojani shumen prej 5.240.000 Leke dhe shumen prej 52.400 USD.

-Detyrimi i te paditurve Astrit Vata dhe Ardit Vata te paguajne fitimin e munguar ne formen e interesave per depoziten me afat njevjecar, sipas normave te interesit te shpallura nga Banka e Shqiperise, nga data 20.07.2011 deri ne daten e aktit te ekspertimit 18.05.2016 ne shumen 1.038.162 Leke dhe 3.589 USD. Pas kesaj date interesat do te perlllogariten ne te njejten menyre ne fazen e ekzekutimit te vendimit te gjykates.

-Shpenzimet gjyqesore u ngarkohen te paditurve.

Per kete titull ekzekutiv eshte leshuar urdhri i ekzekutimit me Nr. 819/U date 07.02.2017 nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Pas kalimit te afatit te lajmerimit per ekzekutimin vullnetar te detyrimit, permbaruesi gjyqesor ka vijuar ne fazen procedurale te ekzekutimit te detyrueshem.

Per kete arsye:

Ne baze te neneve 527 e ne vijim te K. Pr. Civile ;

**URDHEROJ**

Vendosjen e mases se sekuestros konservative mbi kuotat qe debitori Ardit Vata, i biri i Astritit, i dtl. 06.11.1956, ka ne Shoqerine “DEJA CONGLOO” identifikuar me NIPT L98221902K.

Sekuestro konservative te qendroje deri ne nje urdher te dyte nga ana jone.

Per veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini ne dijeni ne menyre shkresore brenda afatit ligjor.

Per personat qe behen pengese ne zbatimin e ketij urdhri do te merren te gjitha masat e parashikuara ne nenin 606 e ne vijim te K. Pr. Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohet ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.

ZYRE PERMBARIMORE L.D.C  
PERMBARUES GJYQESOR

**Lefter CANAJ**

